



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-137

Prishtinë, më 9 dhjetor 2013, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 9 DHJETOR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Sasha Milosavleviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi;

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një pikë shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 dhjetor 2013,
2. Vazhdimi i seancës plenare,
3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
4. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave,
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 dhjetor 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 2 dhjetor 2013.

2. Vazhdimi i seancës plenare

Kryesia, pas diskutimeve, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare, e filluar më 5 dhjetor 2013, t'i vazhdojë punimet të enjten, më 12 dhjetor 2013, në orën 11:00, me këtë:

Rend dite

1. Votimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2012,
2. Emërimi i kryetarit dhe i anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e radhës të mbahet më 12 dhjetor 2013, në orën 12:00, këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës,

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për investimet e huaja,
7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për prokurimin publik në Republikën e Kosovës,
8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike,
9. Zgjedhja e katër anëtarëve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
10. Zgjedhja e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media,
11. Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për zëvendësimin e një anëtari në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

4. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

1. Njoftimi i presidentes së Republikës së Kosovës, znj Atifete Jahjaga, për t'iu adresuar Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me njoftimin e lartshënuar, vendosi që Kuvendi të enjten të mbajë seancën plenare, në orën 10:00 me këtë:

Rend dite

1. Adresimi i presidentes së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Njoftimi lidhur me procedurat e tenderimit për ofruesin e shërbimeve profesionale për procesin e riorganizimit të ndërmarrjes “Trepça”

Kryesia, pasi diskutoi për kërkesën e lartshënuar, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri që ta shqyrtojë kërkesën e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për procedurat e tenderimit për ofruesin e shërbimeve profesionale për procesin e riorganizimit të ndërmarrjes “Trepça”, si dhe të bisedojë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit lidhur me sqarimin e procedurave të tenderimit dhe të statusit juridik të ndërmarrjes “Trepça” dhe të rekomandojë për veprime të mëtejme.

3. Propozimi i GP të PDK-së për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin Parlamentar për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Kryesia propozimin e lartshënuar e radhiti në rend të ditës për seancën plenare të radhës.

4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i kryetarit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, Zenun Pajaziti, zëvendëskryetares së parë të këtij Komisioni, Teuta Sahatqija, si dhe koordinatorit të komisionit, Armend Ademaj, për të marrë pjesë në takimin e përbashkët të komisioneve, në temën “Tregu i Brendshëm i Energjisë së BE-së në shekullin XXI”, i cili do të mbahet në Bruksel, prej 16-18 dhjetor 2013.

2. Të gjitha shpenzimet e kësaj vizite për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. Njoftimi i Komisionit për Integritet Evropian nga Konferenca e tetë e komisioneve parlamentare për integritet evropian të shteteve pjesëmarrëse në procesin e stabilizim-asociimit të Evropës Juglindore (COSAP)

Kryesia u njoftua me vizitën e Komisionit për Integritet Evropian për pjesëmarrjen në Konferencën tetë e komisioneve parlamentare për integritet evropian të shteteve pjesëmarrëse në procesin e Stabilizim Asociimit të Evropës Juglindore-COSAP, e cila është mbajtur në Shkup, më 24 dhe 25 nëntor 2013.

6. Njoftimi i deputetit Etem Arifi për dorëheqje nga GP “Ardhmëria e Përbashkët”

Kryesia, në bazë të nenit 20, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, u njoftua nga deputeti Etem Arifi, se prej datës 27 nëntor 2013 është tërhequr nga Grupit Parlamentar “Ardhmëria e Përbashkët” dhe se në të ardhmen do të veprojë si deputet i pavarur.

Pika shtesë:

1. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Shqipëri

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

- Lejohet udhëtimi i anëtarëve të Komisionit për Legjislacion, në përbërje: Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Behar Selimi, Ardian Gjini dhe Sreten Ivanoviq, si dhe nga stafi mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi dhe Fehmi Hyseni, për të marrë pjesë në takimet sipas agjendës së planifikuar me institucionet shtetërore të Shqipërisë, prej 9-12 dhjetor 2013.
- Të gjitha shpenzimet e kësaj vizite për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi, si dhe shpenzimet për vozitësin e Kuvendit mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Të ndryshme:

Nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti, e shtroi çështjen e udhëtimeve zyrtare të deputetëve jashtë vendit. Ai theksoi se në bazë të pasqyrave të shpenzimeve, të paraqitur në mënyrë individuale për secilin deputet, komision apo subjekt lidhur me realizimin e udhëtimeve zyrtare duhet bërë një analizë, në bazë të së cilës në të ardhmen duhet të planifikohen dhe bashkërendohen më mirë udhëtimet zyrtare jashtë vendit.

Ardian Gjini, kryetar i GP të AAK-së, tha se për ta rregulluar çështjen e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit duhet të nxirret një udhëzim, me të cilin parashihen kriteret dhe mënyra e udhëtimeve.

Kryetari, pas diskutimeve të lartshënuara, theksoi se është e domosdoshme që të nxirret një akt juridik, me të cilin parashihen kriteret dhe rregullat për lejimin e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, si dhe mbulimi i shpenzimeve për udhëtimet e deputetëve, të komisioneve parlamentare, të organeve të Kuvendit dhe të Administratës së Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale